



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-039

Prishtinë, më 31 tetor 2011, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 31 TETOR 2011

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit,

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit:** Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skender Reçica,

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca,

**Nga OSBE:** Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

### **R e n d d i t e**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 18 dhe 25 tetor 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjet plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave.

#### **1. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 18 dhe 25 tetor 2011**

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 18 dhe 25 tetor 2011, u miratuan pa vërejtje.

#### **2. Përgatitjet për mbledhjet e ardhshme plenare**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të premten, më 11 nëntor 2011, me këtë:

### **R e n d d i t e**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregti me jashtë,
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje,
7. Shqyrtimi i Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Ndërkohë, nëse përgatiten edhe pika të tjera, mund të radhiten për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për 11 nëntor 2011.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me rastin “Kiçina”**

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet për diskutim në mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 11 nëntor 2011.

#### **3.2. Kërkesa e deputetit Ramë Vataj, e mbështetur nga 49 deputetë të Kuvendit, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohej nga propozuesi që ta sqarojë kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës:

- a) A harton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, apo
- b) Kërkon që Qeveria e Republikës së Kosovës ta hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

2. Pas sqarimit të cekur më lart, kërkesa t’i parashtrohet Kryesisë së Kuvendit, për procedim të mëtejshëm.

#### **3.3 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me projeksionin e shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës, për periudhën tetor-dhjetor 2011**

Kryesia u njoftua me Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me projeksionin e shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës, për periudhën tetor-dhjetor 2011.

#### **3.4 Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel**

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të realizuar në Bruksel, më 3-6 tetor 2011.

### **3.6 Kërkesë e deputetes Myzejene Selmani për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes së Kuvendit, znj. Myzejene Selmani, në Bruksel, prej datës 29 nëntor deri më 1 dhjetor 2011.
2. Të gjitha shpenzimet e akomodimit, transportit dhe mëditjet shtesë për të lartpërmendurën në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Grupit Parlamentar “6+”.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

**Jakup KRASNIQI**

Procesverbalin e hartoi:  
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.